

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaCem® ExtraBond-100

ADITIV PËR PËRMIRËSIMIN E LLAÇEVE

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaCem® ExtraBond-100 është një aditiv në formë lëngu qumështor të përqëndruar dhe me teksturë për llaçin me bazë çimentoje, suvanë, llaçin për riparim dhe hidroizolim ose llaçin e dyshemesë.

PËRDORIMET

Përdoret në mikset e betonit dhe llaçit për:

- Spruco, suva dhe llaçe
- Suva i hidroizoluar dhe veshje me ndërkapje të lartë dhe plasaritje të reduktuar
- Llaçe/veshje dyshemesh me rezistencë të lartë me prodhim më të pakët pluhuri mbi sipërfaqe dhe rezistencë më të lartë ndaj ujit dhe konsumimit
- Llaçe për riparime lokale dhe riprofilizime
- Llaçe për mbushjen e fugave të mureve

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Ofron punueshmëri të shkëlqyer dhe ndërkapje shumë të mirë
- Rrit fleksibilitetin
- Pakëson përshkueshmëri dhe rrezikun për plasaritje
- Përmirëson qëndrueshmërinë ndaj abrazionit
- Rrit rezistencën kimike dhe rezistencën ndaj ngricës
- Dozim dhe aplikim i lehtë
- Kompatibilitet me produkte të tjera nga Sika

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Rrëshira të përmirësuara stireni
Ambalazhi	Kovë 1 kg dhe 5 kg
Paraqitja / Ngjyra	Lëng i bardhë
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal, të mbyllur dhe të padëmtuar në kushte të thata dhe i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe ngrica.
Dendësia	~ 1.0 kg/l (në +20°C)
Vlera e pH	~ 9.5 (në +20°C)

TË DHËNA TEKNIKE

Receta e Ilaçit

Llaç lidhës

Përbërësit e thatë:

- 1 pjesë për vëllim çimentoje
- 1 pjesë për vëllim rëre

Hollimi i SikaCem® ExtraBond-100 me ujë:

- 1:1 deri në 1:2 për vëllim SikaCem® ExtraBond-100

Llaçe të hidroizoluar

Përbërësit e thatë:

- 1 pjesë për vëllim çimentoje
- 3 pjesë për vëllim rëre

Hollimi i SikaCem® ExtraBond-100 me ujë:

- 1:2 deri në 1:3 për vëllim SikaCem® ExtraBond-100

Llaçe për aplikime të përgjithshme

Përbërësit e thatë:

- 1 pjesë për vëllim çimentoje
- 3 pjesë për vëllim rëre

Hollimi i SikaCem® ExtraBond-100 me ujë:

- 1:3 deri në 1:5 për vëllim SikaCem® ExtraBond-100

Suvatime

Përbërësit e thatë:

- 1 pjesë për vëllim çimentoje
- 1 pjesë për vëllim rëre

Hollimi i SikaCem® ExtraBond-100 me ujë:

- 1:3 deri në 1:4 për vëllim SikaCem® ExtraBond-100

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Doza e rekomanduar

Në të gjitha rastet (shih recetën e Ilaçit), përzieni bashkë përbërësit e thatë dhe pastaj shtoni hollimin e SikaCem® ExtraBond-100 me ujë në sasinë e kërkuar, derisa të prodhohet një miks homogjen me punueshmërinë e kërkuar.

Konsumimi

Në përgjithësi, 5-10% për peshë çimentoje në varësi të aplikimit.

UDHËZIME APLIKIMI

METODA E APLIKIMIT / MJETET

Hapi 1: Shtoni produktin brenda ujit për përzierje sipas raportit të specifikuar për llojin e aplikimit.

Hapi 2: Përzieni bashkë përbërësit e thatë, shtoni holluesin në sasinë e kërkuar ndërsa përzieni për të paktën 90 sekonda, derisa të prodhohet një miks homogjen me punueshmërinë e kërkuar.

- Duhet të ndiqen rregullat standarde të praktikës së betonimit, për sa i përket prodhimit dhe hedhjes së betonit.
- Betoni i freskët duhet të maturohet saktë dhe të aplikohet sa më herët të jetë e mundur. Gjatë maturimit duhet të mbrohet nga ngrica dhe tharja e parakohshme.
- Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit.

KUFIZIME

- Rekomandohet kryerja e testimeve paraprake përpara betonimit në kantier, sidomos kur përdoret një recetë e re, pasi prodhimi i miksit më të mirë varet nga disa parametra si cilësia e rërës, temperatura, lagështia, etj.
- Nuk rekomandohet hollimi i SikaCem® ExtraBond-100 për shtimin e ndërkapjes, pa shtuar raportin e rekomanduar çimento: rërë.
- SikaCem® ExtraBond-100 nuk duhet të shtohet në miksionin e thatë të çimentos dhe agregateve.
- Koha e saktë e përzierjes varet nga mikseri dhe intensiteti i përzierjes.
- Raportet e përzierjes që përmenden më sipër janë thjesht treguese. Konsumimi i SikaCem® ExtraBond-100 mund të ndryshojë në varësi të aplikimit.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaCem® ExtraBond-100

Maj 2019, Botimi 01.01

020301010010000244

SikaCemExtraBond-100-sq-AL-(05-2019)-1-1.pdf